



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2020:113660  
Datë: 12.02.2024  
Numri i dokumentit: 05386409

**Ac.nr.6194/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci-kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.S., nga fshati S., Komuna e Vitisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.M., avokat në Ferizaj, kundër të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.B., avokat në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, C.nr.869/2020, të datës 11.06.2021, në seancën e kolegjit me datë 12.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, C.nr.869/2020, i datës 11.06.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.869/2020, të datës 11.06.2021, ka vendosur si në vijim: “ I. MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.S. (Xh.) nga fshati S., Komuna e Vitisë, DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë që paditëses t’ia kompensoj dëmin material dhe jo material që kishte pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 06.09.2019, për këto baza:

Kompensimi për dëmin jo material

- për dhimbjet fizike të intensitetit të rëndë për dy (2) ditë, në shumën prej 800 Euro,
- për dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për 21 ditë, shumën prej 400 Euro,
- për dhimbje fizike të intensitetit të ulët për 8 muaj, shumën prej 300 Euro,
- Për gjitha llojet e frikës shumën prej 500 Euro,

Gjithsej dëmi jo material 2,000 Euro ( dymijë euro).

- Kompensimi për dëmin material shpenzime sipas faturave e kuponëve fiskal 211 Euro,
- Për shërimin fizioterapeutik klimatik në banjë shumë prej 220 Euro.

Gjithsej dëmi jo material dhe material është 2,431 euro (dymijë e katërqind e tridhjetë e një euro).

Të gjitha me kamatë prej 8%, për dëmin jo material dhe material, ku kamata për dëmin material do të llogaritet nga data 14.09.2020 (datë kur është dorëzuar padia në gjykatë), ndërsa për dëmin jo material nga data 11.06.2021 (nga data e vendosjes me këtë aktgjykim), nën rrezikun e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura K.S. "S." t'ia kompensoj paditëses edhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: 104 euro për përpilimin e padisë, 30 euro për pagimin e taksës për padi, 405 euro për përfaqësim nga avokati në tri seanca gjyqësore dhe 240 euro për dy ekspertiza mjekësore, apo gjithsej 779 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura përmes të autorizuarit të saj për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, dhe aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala paditëse.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 195 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 14.09.2020, në Gjykatën Themelore në Gjiilan, Dega në Viti, ka paraqitur padi, kundër të paditurës për kompensim të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit më datë 06.09.2019. Në referatin e padisë ka parashtruar së deri të aksidenti i trafikut në të cilën paditësja ka pësuar lëndime trupore ka ardhur kur dy ngasësit e automjeteve A dhe B kanë qenë duke lëvizur në rrugën ..., me të arritur në hyrje të fshatit S. automjeti A "Mercedes Benz", me targa të regjistrimit ..., i siguruar tek e paditura, duke mos e mbajtur distancën e mjaftueshme e ka goditur në pjesën e pasme automjetin B "VW Golf", me targa të regjistrimit ..., në të cilën automjet ka qenë pasagjere paditësja, e cila për shkak të lëndimeve të pësuar është detyruar që të kërkoj ndihmë mjekësore në emergjencën e Spitalit të Përgjithshëm në Gjiilan. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, në seancën e shqyrtimi kryesore të mbajtur me datë 25.05.2021, e ka precizuar kërkesëpadinë duke u tërhequr nga kërkesa për kompensimin e dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmën nga personi i tretë, ashtu që ka kërkuar vetëm kompensimin për dëmin jo material për dhimbje fizike dhe për frikë në shumë prej 2,000.00 euro, dhe dëmin material për shpenzimet e shërimit në shumë prej 211.00 euro, ndërsa për shërimin fizioterapeutik në

shumën prej 220.00 euro, dhe duke qenë së baza juridike nuk ka qenë kontestuese i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet si e bazuar, me kamatë prej 8%, për dëmin jomaterial duke filluar nga dita e vendosjes me aktgjykim, ndërsa për dëmin material nga dita e paraqitjes së padisë, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E paditura përmes përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë por vetëm lartësinë e saj pasi që sipas të paditurës shumat e kërkuara nga paditësja bien ndesh me lëndimet e shkaktuara.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar të paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.869/2020, të datës 11.06.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, me provat e administruara, përkatësisht në bazë të raportit të aksidentit me numër 2019-CR-536, të datës 06.09.2019, ka gjetur se me datën 06.09.2019, në hyrje të fshatit S., Komuna e Vitisë, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, ku deri tek aksidenti ka ardhur me fajin e drejtuesit të automjetit të udhëtarëve të tipit “Mercedes”, me targa ..., i cili ka pasur policë të sigurimit tek e paditura, në të cilin aksident paditësja në cilësi të bashkudhëtares në automjetin e tipit “VW Golf”, me targa regjistrimi ..., ka pësuar lëndime trupore. Se aksidenti është shkaktuar me fajin e të siguarit të të paditurës nuk është kontestuar nga e paditura. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë për shpërblimin e dëmit jo material dhe material ka vendosur duke marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr.S.D., ortoped-traumatolog, dhe Dr.G.H., psikiatër, të cilët në seancën e datës 12.05.2021, kanë konstatuar se paditësja në këtë aksident ka pësuar lëndime të lehta trupore, ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, të mesëm dhe të ulët, kishte pasur nevojë për ndihmën nga personi i tretë, për ushqim të përforcuar dhe rehabilitim fizioterapeutik-klimatik për disa ditë në ndonjë banjë, dhe e njëjta kishte përjetuar frikë sekondare, frikë që edhe tani manifestohet dhe shfaqet në disa raste, ndërsa në bazë të fletëlëshimit me numër 24513, të lëshuar nga qendra rehabilituese klimatike “B.K.”, në Kllokot, e shoqëruar me dëftesën dhe kuponin fiskal në shumë prej 220 euro, gjykata ka vërtetuar së paditësja ishte trajtuar në këtë banjë nga data 01.10.2019 deri me datën 11.10.2019, për 10 ditë për aq sa ishte preferuar edhe nga eksperti ortoped Dr.S.D., gjatë ekzaminimit të saj drejtpërdrejt në seancën e datës 12.05.2021. Edhe kuponët fiskal tjerë në numër të madh në shumë prej 211 €, i arsyetojnë format e dëmit material të gjykuar nga gjykata, e të cilët kauzalitetin e kanë si pasojë e shkaktimit të aksidentit. Bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë i ka gjykuar paditëses kompensimin e dëmit, ashtu siç është përcaktuar në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar duke vlerësuar se me shumat e gjykuara paditëses do t'i shërbejnë si një dëmshpërblim real për të gjithë atë që e ka përjetuar në atë aksident. Lidhur me mënyrën e vendosjes është bazuar në dispozitat e nenit 183 të LMD-së, kurse kamatën e gjykuar e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme në lidhje me bazën e kërkesëpadsisë dhe lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësja.

Lidhur me pretendimet ankimore të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk qëndrojnë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse, të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor, nga ku baza juridike e kërkesëpadsisë nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse, ndërsa për lartësinë e kërkesëpadsisë gjykata ia ka falur besimin mendimit profesional ekspertëve të mjekësisë Dr.S.D. ortoped, dhe Dr.G.H., psikiatër, të dhënë në seancën për shqyrtim kryesor të datës 12.05.2021, me çka është përcaktuar natyra dhe lloji i lëndimeve trupore, kohëzgjatja dhe intensiteti i dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, nevoja dhe kohëzgjatja për rehabilitim fizioterapeutik, duke i vlerësuar edhe kjo gjykatë ekspertizat të punuara në mënyrë profesionale dhe me sqarime të mjaftueshme për tu vërtetuar format e dëmit dhe lartësia e tyre. Ndërsa dëmi material për shpenzimet e mjekimit dhe për rehabilitim fizioterapeutik, është i bazuar në mendimin e ekspertëve dhe në kuponët fiskal në bazë të se cilëve vërtetohet së paditësja e ka pësuar një dëm të tillë.

Gjykata e Apelit nuk e pranon pretendimin ankimor për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, sepse e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, ashtu që ka vlerësuar se shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, janë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë dhe të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit që është një lloj satisfaksioni për palën e dëmtuar që sado pak t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, e që është në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 183 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve-LMD, si dhe praktiken gjyqësore. Sipas nenit 136 par.1 të LMD-së është paraparë së *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Tutje neni 137 të LMD-së, përcakton se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i*

*humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Ndërsa në nenin 159 par. 1 i LMD-së, është paraparë së: “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”. Në nenin 179 par.1 të LMD-së, është paraparë së “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”. Kurse me dispozitën e nenit 183 par.1 dhe 2 të LMD-së përcaktohet se: “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj dhe me qëllim shoqëror”. Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase konsideroi se shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë janë proporcionale me shkallën e përgjegjësisë së të paditurës në dëmin e shkaktuar dhe lëndimet të cilat i ka pësuar paditësja në aksident dhe të gjitha rrethanave tjera të cilat janë më rëndësi për vlerësimin dhe caktimin e kompensimit, e me të cilat do të arrihej qëllimi i kompensimit të drejtë të dëmit të pësuar me aksidentin në komunikacion, e duke u bazuar në ekspertizat mjekësore.*

Gjykata e shkallës së parë për shumata e gjykuara ka caktuar kamatën e cila për dëmin jomaterial fillon të rrjedh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, ndërsa për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë, gjë që është në pajtim me të drejtën materiale në këtë rast nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është vlerësuar se është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, dhe në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitën e nenit 452 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6194/21 me datë 12.02.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci